



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10,
NR.6
TEL: 694074311

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2084

Nr. koleksioni: 1614

Tirane më 07/06/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2021051400173458881



KONTRATË SHIT- BLERJE KUOTASH KAPITALI

Në Tiranë sot, më datë 01/06/2021 (dymijë e njëzet e një), para meje Noter Alket Z. Mamçka me seli në Rrugën „Asim Zeneli, Pll. Nr10 Zyra 6 Tirane, u paraqitën personalisht, palët e poshtëshënuara, të cilët me vullnetin e tyre të lirë, ranë dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë :

PALA SHITËSE

Shoqëria "Green Coast" Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L41329038D, me seli në "Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr. 31, Tiranë", përfaqësuar nga administratorja Znj. Çeljeta Apostol, shtetase shqiptare, lindur më 24.04.1973, në Krujë (Laç), mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 036037229 dhe me numër personal H35424057N, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar (këtu e tutje referuar si "Shitësi");

dhe

PALA BLERËSE

Z.Charles Michael BOURI, shtetas Anglez, lindur ne Londer, me date 15.07.1972 dhe banues ne Tirane me adrese te deklaruar Godina "Torre Drin", mbajtes i pasaportes me Nr.560537763, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar (këtu e tutje referuar si "Blerësi").

Palët kanë vendosur dhe rënë dakord si me poshte ne kete kontrate:

1. Shitësi gëzon të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe zotërimit të 1 (një) kuote me një vlerë nominale prej 1.000 LEK (një mijë lekë), të cilat përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë Seaside Residence IV Sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, kati 4, apartamenti 31, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: M11401013R.
2. Shitësi shet, transferon dhe dorëzon pronësinë e plotë dhe zotërimin e kuotës të cilësuar këtu më sipër, konkretisht të 1 (një) kuote me një vlerë nominale prej 1.000 LEK (një mijë lekë), të cilat përfaqësojnë 100% (një përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë Seaside Residence IV Sh.p.k. dhe të gjitha të drejtat e detyrimet që ai gëzon si ortak, ja kalon blerësit, i cili pranon t'i blejë, për një çmim të barabarte me 1.200 LEK (një mijë e dyqind lekë) (këtu e tutje referuar si "Çmimi").
3. Blerësi do të paguajë brenda datës dites se neserme te firmosjes se kesaj kontrate Çmimi e plote prej 1.200 LEK në llogarinë bankare të Shitësit me këto të dhëna:
Emri i Bankës:Tirana Bank SH.A.
Titullari i llogarisë: Seaside Residence II Shpk
IBAN: AL10 2061 1011 0000 1103 2228 6100
Kodi SWIFT:TIRBALTR
4. Shitësi në këtë mënyrë deklaron që kuota e transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje është e lirë dhe e pastër nga çdo peng, barrë siguroese, kufizim, garanci e një tjetër natyre, kufizim ose nga ndonjë pengesë ligjore në përgjithësi.
5. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje dhe ne cdo rast me shlyerjen e çmimit të shitjes, Shitësi nuk ka dhe nuk do të këtë ndonjë pretendim tjetër përkundrejt Blerësit në lidhje me blerjen e kuotës së mësipërme.

Në çdo rast vetëm pagesa e plotë e çmimit nga Blerësi është kusht thelbësor për përfitimin e pronësisë së kuotës nga Blerësi sipas objektit të kësaj marrëveshjeje. Me pagesën e plotë të Çmimit nga Blerësit, shitja quhet e kryer dhe Blerësi përfiton pronësinë e aksioneve.

6. Pas transferimit të mësipërm të kuotës, veprim i cili për të shmangur çdo dyshim do të jetë i vlefshëm dhe ekzekutohet në zyrën e qendrës së biznesit (QKB) vetëm pasi të jetë paguar çmimi i plotë në përputhje me pikat (2), (3) dhe (5) më lart, Shitësi nuk gëzon më asnjë të drejtë ose titull mbi kuotën e mësipërme dhe Blerësi, të cilit kuota i është transferuar dhe dorëzuar, përta i përket pronësisë dhe posedimit, do të gëzojë të drejtën t'a



A2021051400173458881

zotërojnë, posedojë, përdorë, shfrytëzojnë dhe disponojë ato me vullnetin e tij të lirë si pronar dhe posedues i saj. Blerësi gëzon të drejtën të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.

7. Blerësi do të vijojë me regjistrimin e nevojshëm të transaksionit në fjalë në Regjistrin e Biznesit të mbajtur në Qendrën Kombëtare të Biznesit vetëm pasi të jetë paguar Çmimi i plotë në përputhje me pikat (2) dhe (3) më sipër.
8. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj marrëveshje do të paraqitet për zgjidhje pranë Gjykatave kompetente të Tiranës.
9. Palët kontraktore sipas kësaj marrëveshje heqin dorë nga çdo e drejtë e ankimimi të kësaj marrëveshje.
10. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët.

NË DËSHMI TË PALËVE, kjo marrëveshje u hartua në 3 (tre) kopje origjinale me nga 2 (dy) faqe secila, nga palët, të cilat me leximin e saj nënshkruajnë aktin në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

PALA SHITËSE
Green Coast Sh.p.k.
përfaqësuar nga Çeljeta Apostoj

Çeljeta Apostoj


[Signature]

PALA BLERËSE
Z. Charles Michael BOURI

Charles Bouris

NOTER
ALKET Z. MANÇKA

[Signature]





EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L41329038D	
2. Data e Regjistrimit	29/01/2014	
3. Emri i Subjektit	GREEN COAST	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	29/01/2014	
6. Kohëzgjatja	Nga: 29/01/2014	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr.31	
8. Kapitali	2.658.582.828,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	<p>Objekti përsor i veprimtarise se shoqerise eshte Projektimi, ndertimi, venia ne shfrytezim e nje kompleksi turistik, nje strukture hotelerie dhe e objekteve turistike sezonale ne Palase. Shitja e objekteve me destinacion rezidencial veror dhe/ose administrimi i tyre, si dhe ofrimi i sherbimeve te hoteleri-turizmit ne zone e Palases, si dhe cdo veprimtari tjetër plotesuese, qe lidhet direkt ose indirekt me vepimtarine e siperpermendur. Shoqeria mund te bashkepuoje dhe/ose bleje/perfitoje direkt ose indirekt pjesemarrje, ne shoqeri, ndermarrje, agjenci apo siper marrje te tjera, te cilat kane fushe veprimtarie te ngjashme. Gjithashtu, shoqeria mund te kryeje cdo veprim apo opercion tjetër qe ka te beje me pronen e paluajtshme, te luajtshme, cdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te Shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundërshtim dhe te mos alterojne objektin përsor te Shoqerise.</p>	
10. Administratori/ët	Çeljeta Apostol	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 16/05/2020	Deri: 16/05/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		

12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka) 12.1 Afati i emërimit	Dega ne Shqiperi e Shoqerise ERNST & YOUNG - EKSPERTE KONTABEL TE AUTORIZUAR	
	Nga: 21/10/2020	Deri:
13. Ortakët 13.1 Vlera e kapitalit 13.2 Numri i pjesëve 13.3 Pjesëmartja në përqindje (%)	Balfin - Balkan Finance Investment Group	
	Para: 2.658.582.828,00	Natyre:
	1,00	
	100,00	
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Vlore Himare PALASE Plazhi Dhraleos, Himare, Nr. Pasurie 68/120, Vol. 2, Faqe 6 dhe Pasuria 68/121, Vol. 2, Faqe 7, ZK. 1739 Vlore Himare DHERMI Rruga Nacionale Dhermi-Vlore, ne vendin e quajtur "AJO NIKOLLA, Dhrale dhe me Nr.Pasurise :ZK 1481-1739	
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: GREEN COAST E-Mail: c.apostoli@greencoast.al Telefon: 0698081300	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 07/06/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Depozite ne Arke/Cash Deposit

<u>Dega/Branch</u> FUSHE-KRUJA Branch	<u>Data/Date :</u> 11/06/2021	<u>Ora/Time :</u> 16:15:03	<u>Arketari/Teller :</u> T897	<u>Trnx ID :</u> 00000169496
--	----------------------------------	-------------------------------	----------------------------------	---------------------------------

<u>Klienti/Customer :</u> EGJONI 245597	<u>Date Valuta/Value Date :</u> 11/06/2021	<u>Shuma/ Amount :</u>	<u>Shuma/Amount</u>
---	---	----------------------------	---------------------

ALL	1,200.00
-----	----------

Detajet e Llogarise /Account Details :

Numri i Llogarise: 0110322286100

Emri i Llogarise: SEASIDE RESIDEN

IBAN: AL10206110110000110322286100

<u>Komisioni/ Commission :</u>	ALL	0.00
------------------------------------	-----	------

<u>Shuma Kreditore/ Credit Amount :</u>	ALL	1,200.00
---	-----	----------

Source of Funds/
Burimi i te Ardhurave:
Prerjet/Denominations

ALL	Receive
1000	1
200	1

Pershkrimi/Details :

210000000169496
 CHARLES BOURI
 PAG.KUOTA KAPITALE SIP.KON
 REP2084 KOL 1614 DT 07/06/2021
 DEP ELIO GJONI I20819016A

Emer Mbiemer Firma e Klientit
 Customer Signature

Bank Authorized Signatures
 Firma/t e Autorizuar/a te Bankes

Me nenshkrimin e ketij dokumenti, une deklaroj se fondet e perdorura burojne nga aktivetete te ligjshme dhe nuk perfaqesojne veprim i cili nuk eshte ne perputhje me ligjin. Banka nuk mban pergjegjesi per gabimet qe rrjedhin nga instruksionet e pasakta te urdheruesit.

